

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm Dvizioni Civil**, me gjyqtaren Mevlide Shaban dhe sekretaren juridike Hyrije Sylejmani, në lëndën kontestimore të paditësit B. S. nga fshati ..... – Komuna e Kamenices, te cilin me autorizim e perfaqson av. Avni Leci nga Prishtina, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Faik Sylejmani nga Prishtina, jurist pranë të paditurës, baza e kontestit-kompensimi i dëmit, e pas mbajtjes së seancës kryesore më dt. 01.04.2016 mori këtë :

### **A K T G J Y K I M**

**I.PJESËRISHT APROVOHET** si e bazuar kërkespadija e paditësit, B. S. nga fshati ..... dhe **DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve “BKS” me seli në Prishtinë që paditësit në emër të kompensimit të dëmit të pësuar në aksidentin e datës 25.09.2014. t’ia paguaj shumat si vijon: Për dhimbje fizike ,shumën prej 6.000 €, për frikë ,shumën prej 4.000 €, për zvogëlim të aktivitetit jetësorë dhe vuajtje psikike e shpirtërore ,shumën prej 4500 €, për shpenzimet e mjekimit shumën prej 3635,34 €, për kujdesin dhe ndihmën e huaj shumën prej 450 €, për ushqim të përforcuar shumën prej 225 €, gjithsejtë 15,810 €, ( duke mos e llogaritur edhe shumën prej 3000€ pasi që paditësi më parë i ka pranuar si paradhënie) me kamatë vjetore prej 8 % ,duke filluar nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi me datë 01.04.2016, e deri në përmbushjen definitive të obligimeve të krijuara si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

**II. Për tepricën e kërkespadiës** me të cilën paditësi ka kërkuar që e paditura t’ia kompenzojë në emër të kompenzimit të dëmit të pësuar edhe shumën prej 8,728 €, **REFUZOHET** si e pa bazuar .

**III.DETYROHET** e paditura që paditësit të ia kompenzojë shpenzimet e procedurës kontestimore edhe atë 208 € për përpilimin e padiës, 811 € për përfaqsimin në tri seanca , 390 € për shpërblimin e ekspertëve, 75 € për taksë gjyqësore, 50 € për përpilim të aktgjykimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmëris së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Paditësi B. S., nga fshati ....., Komuna e Kamenicës, nëpërmjet të autorizuarit të tij ,ka parashtruar padi në këtë gjykatë, kundër të paditurës KS”BSK”, me seli në Prishtinë dhe në padi ka deklaruar se me datën: 25.09.2014, në fshatin ..... me fajin e vozitesit D. T. I cili ishte duke e drejtuar motoqikletën e markes “CENIKS” në rrugën dytesore (afër varrezave), nga pakujdesia dhe mos përshtatja e shpjtesis së lëvizjes të motoqikletës ndaj

kushteve të rruges e ka goditur paditësin , ku me atë rast ka shkaktuar lëndime të rënda trupore i cili ishte duke ecur në cilësin e këmbësorit.

Perfaqsi I paditësit në shqyrtimet gjyqesore ka deklaruar se e paditura edhe në procedure të rregullt administrative, edhe në përgjegje në padi nuk e ka kundërshtuar bazën juridike të kërkespadiës por vetëm lartësin e dëmit dhe shumën e ofruar prej 6.590€ nga e paditura nuk është adekuate me natyrën e lëndimeve trupore që ka pësuar paditësi si pasojë e aksidentit duke theksuar se deri me tani vetëm shpenzimet e shërimit paditësi ka pasur sipas fakturave dhe kuponave fiskal Shumën prej 3.600€ . Pas nxerrjes së ekspertizës përfaqesuesi i paditësit e ka precizuar kërkespadiën dhe ka shtuar se me që fajtor ekskluziv për shkaktimin e këtij aksidenti është vozitesi i motoqikletës CENIKS, i pa siguruar nga AP e që duke ju referuar edhe dispozitave ligjore të LMD-ës dhe ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga autopergjegjesia, dispozites ligjore të nenit 18 alineë 1 dhe 1 të këtij ligji, legjitimitetin pasiv për të kompenzuar dëmin material dhe jo material që I është shkaktuar paditësit nga vozitesi Drilon Thaqi, i perket të paditës (Byroja Kosovare e Sigurimit)- Fondi I Kompenzimit nga Prishtina. Më tej ka shtuar se duke u bazuar nga raportet mjeksore, mendimi dhe konstatimin e eksperteve mjeksor dr.Fatos Kelmendi neuro kirurg, dr Flamur Blakaj mjeko ligjor si dhe dr Nazmie Musliu psikiater, shihet se paditësi si pasojë e aksidentit trafikut në cilësin e këmbësorit ka pësuar lëndime të rënda trupore të cilat rezultojnë me dëmtim të shëndetit dhe organit.Paditësi B. S. si pasojë e këtyre lëndimeve të marra ka përjetuar dhe pësuar dëme jo material dhe atë:dhimbje fizike trupore dhe për këtë formë të dëmit duke marrë parasysh kohëzgjatjen dhe intenzitetin e tyre e ka precizuar padiën duke kërkuar nga gjykata që të gjykojë Shumën prej 10.300€. Për frikën e përjetuar duke pasur parasysh llojet e frikës, kohëzgjatjen dhe intenzitetin e tyre ka kërkuar me precizim që gjykata të gjykojë Shumën prej 6.200€ për zvoglim të aftësisë së përgjithshme jetësore-për dëme jo material në shkallë prej 15%, duke marrë parasysh moshën e paditësit prej 39 vjeçar i cili ka mbetur invalid dhe dhimbjet e tij fare nuk ndalen as sot e kësaj dite, ku gjatë ecjes vërehet deformimi trupor dhe ka propozuar që gjykata të gjykojë në shumën prej 4.500 € ( për qdo 10% nga 3000€, duke marrë parasysh se kriteret e kompanive për qdo 10% të invaliditetit ofrojnë Shumën prej 1500- 2000 €, dmth kriteret e gjykatave në Republikën e Kosovës janë po thuajse edhe një herë më të larta). Për formën e dëmit jo material shëmtim të shkallës së lehtë duke pasur parasysh se paditësi gjatë ecjes shihet se ka deformimet trupore, ka precizuar dhe kërkuar nga gjykata që të gjykojë Shumën prej 1500 €. Perfaqesuesi i paditësit ka shtuar se të gjitha shumat e precizuara si më lartë i ka bazuar mbështetur në mendimin dhe konstatimin profesional të dhënë nga ekspertet mjeksor, praktikave gjyqesore si dhe duke u bazuar në dispozitën të cilat shumat paraqesin vetëm një shprehje të satisfaksionit moral të nevojshëm për rivendosjen sado pak të barres shpirtërore dhe emocionale të paditësit të rregulluar me rastin e lëndimeve të rënda trupore të pësuar me aksidentin e trafikut . Sa i perket ndihmës dhe kujdesit të huaj nga personi i tretë perfaqesuesi i paditësit ka theksuar se duke u bazuar në

mendimin dhe konstatimin e ekspertëve mjeksor se ndihma për paditësin ka qenë e nevojshme për 90 ditë të cilën e ka dhënë bashkshortja dhe fëmijët e paditësit ka kërkuar Shumen prej 450€, ndërsa për ushqim të përforcuar ka kërkuar Shumen prej 225€. Sa i përket shërimit klimatik –fizioterapeutik po ashtu duke u bazuar në mendimin e dhënë nga ana e ekspertëve mjeksorë e duke i marrë për bazë faturat të cilat gjinden në shkresat e lëndës nga gjykata ka kërkuar që për kërkespadinë sa i përket kësaj forme të demit material ta gjykojë shumën në formë të rentës vjetore prej 728,00€, (26€ shujta ditore në banjë të kllokotit pa përcjellës 28 ditë në vjet). Sa i përket shpenzimeve të shërimit përfaqesuesi I paditësit më tutje ka shtuar se paditësi ka shpenzuar të holla për kontrollime mjeksore blerjen e barnave, si dhe shpenzimet të cilat janë të lidhura ngusht me shërimin e tij si dhe për terapi fizikale të bëra në banjë ashtu që duke ju referuar faturave dhe kuponave fiskal të cilat gjinden në shkresat e lëndës paditësi deri më tani ka shpenzuar shumën prej 3.635,34€, duke i zbritur 3000€, që paditësi kishte marrë në emër të paradhënies nga e paditura, e për pagesë kishin mbetur 635,34€. Në fund përfaqesuesi I paditësit gjykatës I ka propozuar që të aprovoi kërkespadinë si dhe precizimin e padisë si të bazuar si dhe ta detyrojë të paditësin që paditësit tia kompenzojë me kamatë ligjore në shkallë prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive.

Përfaqesuesi i të paditës " BSK" në Prishtinë, Faik Sylejmani, ka deklaruar se mbetet në tërsi pranë përgjegjies në padi, duke ritheksuar se paditësi në emër të paradhënies ka marrë Shumen prej 3000€, ndërsa sa i përket faturave në kupona fiskal janë të pa pranuar duke shtuar se sa i përket shpenzimeve të mjekimit dhe lidhjes kauzale me aksidentin e trafikut të njejtat janë vlerësuar në lartësi prej 1230€. Në fund përfaqesuesi I të paditës ka deklaruar se shumata e kërkuara dhe të precizuara nga ana e përfaqesuesit të paditësit nuk janë në harmoni me praktiken dhe qëllimet që i shërbejnë këtijë kompenzimi dhe me qëllim të ekonomizimit të procedurës palet paditëse i ka ofruar Shumen prej 6.000€, duke mos e llogaritur Shumen prej 3000, në emër të paradhënies, e cila shumë i përfshinë të gjitha format e demit material dhe jo material në harmoni me praktikën e gjertanishme. Gjykatës i ka propozuar që me rastin e vendosjes të ketë parasysh edhe faktin se shumata e gjykuara për këtë qështje do të kërkohen në procedurë rimbursimi ndaj shkaktarit të aksidentit ashtu që shumata e gjykuar përtej shumës së ofruar të refuzohet si e pa bazuar.

Me propozimin e përfaqesuesit të paditësit dhe me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike gjykata ka kërkuar mendimin nga ana e mjekëve ligjor dr. Flamur Blakaj ortoped, dr.Nazmie Musliu psikiatër si dhe dr. Fatos Kelmendi neurokirurg nga QKUK në Prishtinë.

Dr. Fatos Kelmendi neurokirurg gjatë egzaminimit të palet paditëse si dhe duke u mbështetur me dokumentacionin I cili gjendet në shkresat e lëndës ka konstatuar se paditësi me rastin e shkaktimit të aksidentit ka pësuar lëndime të rënda trupore dhe me pasoja të përhershme edhe atë; dhimbje fizike me

intensitet posaçërisht të rëndë dy orë, me të rëndë katër ditë (qëndrim spitalor) dhe me intensitet të mesëm 60 ditë me qenëse pacienti ka mbajtur korset tarakombal më të gjatë. Dhimbje fizike me intensitet të ulët akoma janë prezente kohë pas kohe të cilat dhimbje mund të akutizohen dhe të kalojnë prapë në dhimbje të intensitetit të mesëm dhe se përkundër përdorimit të barnave nga vapenti (lyrica) në dozë prej 150 miligramëve dhimbjet nuk i qetësohen e që kjo është vija e fundit e analgjetikëve për dhimbje kronike. Shëmtim trupor tek paditësi për shkak të spazmës së muskulaturës mund të konsiderohet si shëmtim i lehtë trupor. Pacienti ka zvoglim i aktivitetit jetësor prej 15 % i cili manifestohet me dhimbje të boshtit kurrizor të regjionit lumbal duke i pasur parasysh kufizimet e lëvizjes. Përkujdesja dhe ndihma nga personi i tretë tek pacienti ka qenë e nevojshme edhe atë nga momenti i aksidentit, gjatë qëndrimit spitalor dhe jashtë spitalor si për higjienë personale, veshmbathje gjatë qëndrimit në banje, vizitave mjekësore, shëtitjeve etj, në kohëzgjatje prej 90 ditë. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm tek pacienti për një periudhë kohore prej 45 ditë, ushqim i pasur me proteina dhe vitamina e sidomos me kalcium. Gjatë kësaj periudhe ka qenë e nevojshme terapia fizikale e trajtimit rehabilitues e për të cilën pacienti posedon dokumentacion mjekësor. Lidhur me trajtimin e mëtutjeshëm pacienti në të ardhmen ka nevojë për trajtim fiziatrik (dërgimi në banjë) më së paku dy herë në vite pa përcjellës. Diagnoza është fraktura kompresiva vert.L1-A1 spazmës muskulatura paravertebralisë.

Dr. Nazmie Musliu psikiatëre me rastin e ekzaminimit të pacientit si dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se paditësi – pacienti në aksidentin e pësuar me datë 25.09.2014 ka përjetuar frikë primare në formë të frikës nga vdekja dhe kërcënimin të drejtpërdrejt për integritet të tije fizikë e cila ka zgjatur disa sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë e cila ka zgjatë për 5 ditë e shoqëruar me ankthe dhe shqetësime gjatë gjumit si dhe reagime të natyrës emocionale të cilat ndërlihen me frikën nga invaliditeti i përhershëm. Frikë sekondare të intensitetit të mesëm e cila ka zgjatë rreth dy muaj, periudhë e rikuperimit dhe trajtimit mjekësor të traumës fizike e shoqëruar me brengen e vazhdueshme për të ardhmen shëndetësore të paditësit, frikës se do të mbetet i paralizuar, anktheve dhe çrregullimit të gjumit, rikujtimet e ngjarjes traumatike e cila ka kaluar në frikë sekondare të një intensitetit më të ulët të manifestimit e e cila është prezente sot e asaj dite me shqetësime gjatë gjumit, e me pasoja të përhershme fizike pamundësia e kryerjeve të aktiviteteve jetësore me rënje të performances psikosociale si dhe dëmtim të ekuilibrit dhe dinamikës psikike nga pasoja e lëndimeve të rënda që ka pësuar paditësi si pasojë e lëndimeve të rënda e i cili gjatë kësaj periudhe është konsultuar edhe nga ana e psikiatrit dhe është trajtuar me terapi adekuate qetësuese.

Dr. Flamur Blakaj gjatë ekzaminimit të palës paditëse ka konstatuar se terapia fizikale për tretman të ardhshëm është në kohë të pa caktuar derisa pacientit ti përmirësohet lëvizshmëria e boshtit kurrizor dhe për këtë është e

domosdoshme fizioterapia dy her në vit nga dy javë në banjë. Pacienti për shkak të dhimbjeve kronike përdor pregabolinum (Lyrica 100 mg) bari i cili është i domosdoshëm për trajtimin e dhimbjeve kronike i cili bari duhet të përdoret gjatë varësisht nga gjendja e pacientit e i cili kushton shtrenjte. Nga shqyrtimi i dokumentacionit mjekësor dhe ekzaminimit klinik të pacientit shihet se të gjitha shpenzimet lidhur me trajtimin fizikal të tij si blerja e korsetit , blerja e analgjetikëve, trajtimi në banjë, trajtimi ambulator nga ana e ftiziatrit kan qenë më se të domosdoshme, gjithmonë duke pasur parasysh natyrën e lëndimit .

Me qëllim të vlerësimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje konkrete civilo-juridike, gjykata bëri shikimin dhe leximin e provave edhe atë : Raporti i aksidentit i datës 25.09.2014 me numër 20 14 CB 472 i lëshuar nga policia e Kosovës, raporti i emergjencës lëshuar nga spitali regional në Gjilan me nr. të protokollit 16780 i datës 25.09.2014, fletëlëshimi i spitalit rajonal në Gjilan, reparti i ortopedisë me nr. të historisë 11-264 me datë të pranimit 25.09.2014 dhe datë të lëshimit 29.09.2014, raporti radiologjik i lëshuar nga spitali rajonal ne Gjilan me nr.1123 i datës 25.09.2014 dhe raporti i datës 26.09.2014 me nr. rendor 1136, kupni fiskal me nr.600436572 i datës 26.09.2014, parashtresa e palës padiëse C.nr.85/15 e datës 27.01.2016 për dërgimin e raporteve mjekësore, faturave dhe kuponave fiskal si dhe të gjitha provat tjera materiale të bashkangjitura kësaj parashtrese, përgjegjjen në padi e dhënë nga e paditura me datë 28.01.2016, parashtresa për precizimin e padisë nga ana e palës paditëse e datës 09.03.2016 me të cilën është bashkangjitur edhe prova e ujdisë jasht gjyqësore e datës 13.01.2015, me nr.1660/14, e lidhur në mews të paditësit dhe të paditures për marrjen e akontacionit në vlerë prej 1000€, si dhe ujdia tjetër jashtë gjyqësore e dsat.26.05.2015, me nr. 1660-14, në shumë prej 2000€, mendimi i ekspertëve mjeko ligjorë i dhënë në shqyrtimin e dat. 02.03.2016, me anë të ekzaminimit të drejtëpërdrejtë.

Pas vlerësimit të provave të administruara si dhe deklaratave të ndërgjygjësve dhe fakteve jo kontestuese në mes tyre ,në kuptim të dispozitës së nenit 8 të LPK-së ,gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike :Se me datën 25.09.2014, në fshatin M. K. Kamenicë , ka ardhur deri te shkaktimi i aksidentit të komunikacionit, shkaktar i të cilit ishte vozitësi D. Th. i cili ishte duke e drejtuar motoqikletën e markës Cenerik, i pa siguruar nga AP, i cili nga pakujdesia dhe mos përshtatja e shpejtësisë në lëvizje të motoqikletes ndaj kushteve të rrugës e kishte goditur paditësin B. S., duke e përplasur për tokë ku me këtë rast i shkakton lëndime të rënda trupore këto fakte gjykata i ka vërtetuar me leximin e raportit të aksidentit me nr. Të rastit 2014 CB 472, i cili nuk është kontestuar nga ana e të paditures .

Me rastin e dhënjes së mendimit të mjekëve ligjor- ekspertizës mjekësore, të datës 02.03.2016, të dhënë nga eksperti Neurokirurg Fatos Kelmendi, gjykata ka vërtetuar faktin se si pasojë e aksidentit paditësi kishte

pësuar edhe atë: lëndime të rënda trupore, dhe me pasoja të përhershme edhe ate; dhimbje fizike me intensitet posaçërisht të rëndë dy orë, dhe me intensitet të mesëm 60 ditë, dhimbje fizike me intensitet të ulët akoma janë prezente tek paditësi kohë pas kohe të cilat dhimbje mund të akutizohen dhe të kalojnë prapë në dhimbje të intensitetit të, shëmtim të lehtë trupor, zvoglim të aktivitetit jetësor prej 15 %, i cili manifestohet me dhimbje të boshtit kurrizor të regjionit lumbal duke i pasur parasysh kufizimet e lëvizjes. Përkujdesja dhe ndihma nga personi i tret, ushqimi i përforcuar përperiudhe kohore prej 45 ditë, terapi, fizikale e trajtimit rehabilitues fiziatrik.

Nga mendimi dhe konstatimi i ekspertes dr. Nazmie Musliu psikiatëre , gjykata ka konstatuar faktin se paditësi ka përjetuar frikë primare e cila ka zgjatur disa sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë e cila ka zgjatë për 5 ditë frikë sekondare të intensitetit të mesëm e cila ka zgjatë rreth dy muaj , frikë sekondare të një intensitetit më të ulët të manifestimit e e cila është prezente sot e asaj dite me shqetësime gjatë gjumit , e me pasoja të përhershme fizike pamundësia e kryerjeve të aktiviteteve jetësore me rënje të performances psikosociale si dhe dëmtim të ekuilibrit dhe dinamikës psikike nga pasoja e lëndimeve të rënda .

Nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit dr. Flamur Blakaj, gjykata ka vërtetuar faktin se pala paditëse duhet ti nënshtrohet edhe në të ardhmen terapisë fizikale në kohë të pa caktuar derisa ti përmirësohet lëvizshmëria e boshtit kurrizor dhe për këtë është e domosdoshme fizioterapia dy her në vit nga dy javë në banjë, ndërsa për shkak të dhimbjeve kronike përdor barin i cili është i domosdoshëm për trajtimin e dhimbjeve e i cili kushton shtrenjte.

Gjykata analizuar thënjet e palëve ndërgjyqëse , provat e administruara dhe konstatoi se baza e kërkesëpadisë nuk është kontestuese . sa i përket lartësisë së dëmit të shkaktuar gjykata ka pasur parasysh kriteret të cilat janë të aprovuara nga kompanit e sigurimeve , por në rastin konkret, gjykata ka bërë tejkalimin e tyre për shkak se paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore të cilat janë konstatuar nga ekspertiza mjeksore të kryera nga ana e ekspertëve mjeko ligjor e të cilave gjykata ua fali besimin , sepse nuk janë kontestuar nga palët në kontest.

Sa i përket disa formave të dëmit , siq janë ndihma dhe kujdesi i huaj dhe ushqimit të përforcuar të paditësit pas aksidentit për një kohë të caktuar , që është konstatuar nga ana e ekspertëve mjekësor , e për të cilat pala e paditur thotë se nuk ko prova, gjykata konsideron se është i mjaftueshëm fakti që është përcaktuar nga ana e ekspertëve meqë në këto raste kujdesen antarët e tjerë të familjes , që nuk janë paguar por se është dashur të privohen nga punët e rregullta dhe të kujdesen për paditësin.

Edhe ushqimi i përforcuar nuk është i domosdëshëm të vërtetohet me prova konkrete pasi që është thënë nga ekspertët ndërsa në kushtet tona në këto raste nuk ka se ku të merren prova materiale (fatura).

Gjykata e aprovoi kërkesën e paditësit lidhur me shpenzimet e mjekim në tersi duke e marrë për bazë gjendjen e paditësit i cili ende vazhdon me terapi shumen prej 3635,34, e cila është arsyetuar me fatura dhe kupona fiskal të cilët gjinden në shkresat e lëndës, por me qenëse paditësi në procedurën jashtë gjyqësore lidhur me këto shpenzime nga e paditura kishte marrë shumen prej 3000€, të paditurën e ka obliguar vetëm për shumen prej 635,34€.

Gjykata me rastin e caktimit të të gjitha dëmeve paditësit i ka njohur shumen prej 18,810€, por për faktin se paditësi si paradhënie nga e paditura kishte pranuar shumen prej 3000€, e duke e llogaritur edhe këtë shumë, e obligoi të paditurën që të kompenzoi vetëm për shumen prej 15,810€, te cilat e paditura është e obliguar t'ia paguaj paditësit, si në pikën I. të dispozitiv të këtij aktgjykimi e duke e marrë parasysh se caktimi i kompensimit për dëmin e pësuar të paditësit, është një satisfaksion për të dëmtuarin –paditësin i cili ka pësuar dëm jo material, e kjo me qëllim edhe të rivendosjes së barazpeshes [ekuilibrit] psikik dhe emocional të rrënuar të paditësit dhe kjo gjykatë ka vepruar në pajtim me dispozitat e neneve 185, 195 dhe 200, të LMD-së, si dhe dispozitës ligjore të nenit 18 alineja 1 dhe 2 të ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia, përkatësisht nenit 323 të LPK-së.

Gjykata e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses për tepricën e kërkesëpadisë për shumat më të larta se ato të gjykuara edhe për 8,728 €, me arsyetim se një kërkesë e tillë e paditësit nuk ka mbështetje në kriteret e përcaktuara lidhur me kompensimin e dëmit jo material dhe në vlerësimin e lirë të gjykatës dhe për këtë ka vendosur si në pikën II. të diapozitivit të këtij aktgjykimi.

Nga arsyerat e cekuar më lartë e bazuar në nenin 143 dhe 146 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore është marrë sipas neni 452 të LPK dhe TA.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**Me datë 01.04.2016**

Gjyqtarja  
Mevlide Shabani

**UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK:** kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nëpërmes të kësaj gjykate.

